



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Konkurs për juristë të diplomuar – praktikantë në OAK

01.03.2023, Prishtinë - Oda e Avokatëve të Kosovës mundëson praktikë 1 vjeçare (me pagesë) për 4 (katër) juristë të Fakulteteve Juridike.

Kushtet:

Të jenë juristë të diplomuar sipas programit katër vjeçar ose t'i kenë përfunduar studimet master.

Dokumentet e nevojshme:

- CV
- Letër motivuese
- Diploma e fakultetit juridik në Kosovë apo diplomën nga fakulteti juridik i ndonjë shteti tjetër e nostrifikuar nga Ministria e Arsimit në Republikën e Kosovës (*Kopje e noterizuar*)
- Certifikata që nuk jeni nën hetime (*original*)
- Certifikata që nuk jeni në marrëdhënie pune (*original*)

Gjatë praktikës praktikantët do të;

- Angazhohen në përgatitjen e trajnimeve dhe seminareve të organizuara për avokatë dhe praktikant të avokatisë në kuadër të Qendres Trajnuese për Avokat;
- Angazhohen në azhurnimin e shënimeve në bazën e të dhënave të OAK;
- Angazhohen në Zyren për angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare;
- Angazhohen në Zyrën e Financave;
- Angazhohen në Zyrën e Prokurorit Disiplinor dhe në Zyrës Disiplinore;
- Angazhohen në Zyrën për Komunikim etj.
- Marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të OAK dhe përkrahjen e administratës,
- Marrin pjesë në seancat disiplinore;
- Asistojnë në hartimin dhe përgatitjen e raporteve të aktiviteteve si dhe agjendat e ndryshme;
- Përkrahin stafin e OAK-së në përgatitjen e shënimeve, raporteve, punëve administrative-juridike;
- Ndihmojnë stafin e OAK-së në organizimin e takimeve, konferencave, trajnimeve, seminareve;
- Ndihmojnë në kryerjen e detyrave tjera të përcaktuara nga mbikëqyrësi.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së konkursit dhe dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në zyret e OAK-së në Rr. Bekim Fehmiu pn. (Ndërtesa e Arting), Kati IV - Prishtinë, deri me datë **15 Mars 2023** në ora 16:00.

Do të kontaktohen vetëm juristët që do të ftohen për intervistim.

Prishtinë, 01 Mars 2023